



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 7, datë 09.09.2024

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:10

Data e mbajtjes së mbledhjes : 09.09.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve!

Uroj të keni kaluar pushime të mbara.

Gjithashtu suksese fëmijëve dhe mësuesve në këtë vit të ri shkollor.

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak Durrës. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Ardian Muka ... Mungon.....deri tek.... Florian Tahiri...Prezent.

33 Këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi: Meqenëse anëtarët janë të pranishëm vazhdojmë mbledhjen.

Sot për shqyrtim kemi vetëm pikën 1 e cila është :

Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN GUSHT 2024
--	--

I japim fjalën për pikën 1 Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit z. Florian Tahiri .

Florian Tahiri : Përshëndetje!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale si gjithmonë pikat përta i përket ndihmës ekonomike kalojnë në unimanitet nga të gjithë ne.

Ani Dyrmishi : O më fal Florian, duhet të miratojmë rendin e ditës.

Ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra ... s'ka

Abstenim ...s'ka

Atëhere, me 33 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Atëhere, përta i përket **pikës 1**, i japim fjalën dhe njëherë Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit z. Florian Tahiri.
Zoti Tahiri vazhdo edhe një herë të lutem, sepse ndodhi një problem teknik.

Florian Tahiri : Atëhere, përta i përket pikës nr.1 të rendit të ditës Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, ndihmën ekonomike e kaloj si pikë në unimanitet nga të gjithë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përta i përket pikës 1 kemi nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra? ...Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet, me 33 vota pro pika 1 dhe e vetme e rendit të ditës.

Fjalën për diskutim nuk e kërkoi askush, nëqoftëse kryetarja ka diçka për të shtuar?

Emiriana Sako: Jo nuk kam gjë për të shtuar.

Ani Dyrmyshi: Ju faleminderit.
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 3 (tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Demokratike:

JONUZ MYSHKETA